



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT**

**M E S A Z H  
I  
DREJTORIT TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT,  
z. HELIDON BENDO**

*Të nderuar punonjës të Shërbimit Informativ të Shtetit,*

Sot mbushen 107 vjet nga data e krijimit të Shërbimit Sekret të Shtetit Shqiptar. Duke përfutur nga ky rast, ju shpreh urimet dhe përshëndetjet më të ngrohta.

17 dhjetori i 1912-ës shënon aktin zyrtar të krijimit të këtij Shërbimi, si pjesë e pandarë e themelimit të shtetit shqiptar.

Sot, 107 vjet më pas, Shërbimi Informativ i Shtetit është i përkushtuar në ruajtjen e sigurisë kombëtare dhe mbrojtjen e integritetit, pavarësisë e rendit kushtetues. Puna, sakrificat dhe arritjet e Shërbimit Informativ të Shtetit na sigurojnë që veprimtaria e tij do të mbështetet edhe në të ardhmen në vlerat që besojmë: ligjshmëria, integriteti, profesionalizmi dhe puna në ekip.

*Të nderuar kolegë,*

Më lejoni të shfrytëzoj këtë mundësi për të shprehur edhe në emrin tuaj keqardhjen për humbjen e jetëve, shkatërrimin e pronave dhe zhvendosjen e qytetarëve si pasojë e tërmetit të datës 26 nëntor 2019. Ne jemi në mbështetje të kolegëve tanë, familjeve të tyre dhe të gjithë shqiptarëve, të cilët kanë nevojë për ndihmë konkrete.

*Së fundi*, duke e vënë theksin te përkushtimi juaj i vazhdueshëm, ndjehem mirë që kontributi i punonjësve të SHISH-it për garantimin e sigurisë kombëtare është i mirëvlerësuar nga vendimmarrësit dhe partnerët ndërkombëtarë.

Gëzuar ditën e krijimit të Shërbimit Sekret Shqiptar!

**DREJTORI  
Helidon Bendo**